



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel; 04 2268141; Fax: 2268142

Nr. 92/3 Prot.

Tiranë, më 30.03.2017

**V E N D I M**

**Nr. 64, datë 30.03.2017**

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin nr. 17, datë 09.02.2017"***

Në mbështetje të kompetencës së parashikuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 e 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 77-118, të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme, në përfundim të procedurës së verifikimit,

**VËREJ SE :**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 17, datë 09.02.2017, "Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 90, datë 25.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Bulqizë, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim", mbi bazën e Programit të Verifikimit nr. 92/1 prot., datë 09.02.2017, ka vendosur kryerjen e procesit të kontrollit të akteve të emërimit, të cilat janë marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore për respektimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, për periudhën nga data 27.04.2016 (momenti i përfundimit të mbikëqyrjes së realizuar më parë në këtë institucion) e në vazhdim.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Bulqizë nga grupi i inspektorëve, i autorizuar për këtë qëllim, të cilët u paraqitën në këtë institucion, në datën 22.02.2017.

Për realizimin e këtij procesi, fillimisht u njoftua institucioni, me shkresën nr. 90/2 prot., datë 09.02.2017, "Njoftim për fillimin e verifikimit", dhe më tej u administruan:

- ✓ *Struktura dhe organika e institucionit e miratuar me Vendimin nr. 137, datë 17.05.2016, ndryshuar me Vendimin nr. 173, datë 01.09.2016, të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë.*
- ✓ *Listë-pagesat e punonjësve të institucionit për periudhën maj 2016 - janar 2017.*

- ✓ *Aktet e emërimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kontratat e punës në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.*

Në momentin e verifikimit, konstatohet se Bashkia Bulqizë, funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 137, datë 17.05.2016, ndryshuar me Vendimin nr. 173, datë 01.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 137, datë 17.05.2016 mbi miratimin e strukturës, organikës/kategorive, klasën e pagave, për çdo pozicion të administratës së Bashkisë, Ndërmarrjeve dhe Njësive shpenzuese, në varësi të Bashkisë Bulqizë”.

Verifikimi është realizuar për periudhën që fillon nga momenti i mbikëqyrjes që është kryer më parë në këtë subjekt, deri në datën 22.02.2017, dhe në përfundim rezultoi se :

Në këtë periudhë, rezulton se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Bulqizë, në 28 raste janë emëruar punonjës nëpërmjet akteve të emërimit të përkohshëm apo kontratave të përkohshme të punës në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit. Konstatohet se, për 18 pozicione pune të plotësuara në kundërshtim me ligjin, kanë filluar procedurat e rekrutimit, por ndërkohë punonjësit e emëruar me kontratë, vijojnë të jenë në marrëdhënie pune me institucionin.

Konkretisht, bëhet fjalë për emërimet e punonjësve, në pozicionet e mëposhtme:

- 1) \*\*\*\*\*, me pozicion “Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, emëruar në detyrë me aktin nr. 139/1, datë 25.05.2016.
- 2) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist i Menaxhimit të Pronave në Njësinë Administrative Ostren”, emëruar në detyrë me aktin nr. 154, datë 06.07.2016.
- 3) \*\*\*\*\*, me pozicion “Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Menaxhimit të Pronave”, emëruar në detyrë me aktin, nr. 175, datë 02.09.2016.
- 4) \*\*\*\*\*, me pozicion “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Emergjencave Civile”, emëruar në detyrë me aktin nr. 176, datë 02.09.2016.
- 5) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Trebisht”, emëruar në detyrë me aktin nr. 50, datë 08.01.2016.
- 6) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Gjoricë”, emëruar në detyrë me aktin nr. 150, datë 11.04.2016.
- 7) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Zerqan”, emëruar në detyrë me aktin nr. 199, datë 21.09.2016.
- 8) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Shupenzë”, emëruar në detyrë me aktin nr. 24/1, datë 08.01.2016.
- 9) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Ostren, Trebisht, Martanesh dhe Zerqan”, emëruar në detyrë me aktin nr. 46, datë 08.01.2016.
- 10) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Shupenzë”, emëruar në detyrë me aktin nr. 196, datë 19.09.2016.
- 11) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist veterinarie”, emëruar në detyrë me aktin nr. 95, datë 07.09.2015.
- 12) \*\*\*\*\*, me pozicion “Specialist i Ndihmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Trebisht”, emëruar në detyrë me aktin nr. 49, datë 08.01.2016.

- 13) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Ostren*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 44, datë 08.01.2016.
- 14) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Gjoricë*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 37, datë 08.01.2016.
- 15) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 19, datë 08.01.2016.
- 16) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Martanesh*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 79, datë 08.01.2016.
- 17) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Zerqan*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 21, datë 08.01.2016.
- 18) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist e Barazisë Gjimore dhe Dhunës në Familje*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 195, datë 19.09.2016.
- 19) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Trebisht*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 48, datë 08.01.2016.
- 20) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Ostren*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 43, datë 08.01.2016.
- 21) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Gjoricë*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 42, datë 08.01.2016.
- 22) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 16, datë 08.01.2016.
- 23) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 81, datë 08.01.2016.
- 24) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 27, datë 08.01.2016.
- 25) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialiste e arkivës, në Bulqizë*”, emëruar në detyrë me Kontratën e Punës, datë 01.09.2015.
- 26) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Marrëdhënieve me Median*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 158, datë 21.09.2016.
- 27) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i N.M për menaxhimin e pronave, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 17, datë 08.01.2016.
- 28) \*\*\*\*\*, me pozicion “*Specialist i Kontrollit në Terren*”, emëruar në detyrë me aktin nr. 184, datë 02.09.2016.

Aktet që vërtetojnë situatën e paraqitur, janë të materializuara në procesverbalin e konstatimit, datë 22.02.2017, mbajtur nga grupi i inspektorëve dhe personat e kontaktit të përcaktuar nga ky subjekt, në institucionin e Bashkisë Bulqizë, si dhe janë pjesë e provave të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer për këtë rast.

Komisioneri vlerëson se duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, gjë që në vështrim të nenit 108, pikat i,ii) të gërmës a), dhe gërmës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Bulqizë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113, të po këtij ligji, të bëjë anulimin e akteve administrative të cituara më sipër.

Në këto kushte, bazuar në nenin 113, pika 2, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, anulimi i aktit ka pasoja edhe për të shkuarën, dhe për rregullimin e ligjshmërisë së këtyre rasteve, duhet që gjithë procedura për plotësimin e këtyre pozicioneve të punës, të fillojë nga e para, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

**1.** Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me **28** (njëzet e tetë) rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin, të veprojë si më poshtë:

- ✓ Të anulojë aktin nr. 139/1, datë 25.05.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 154, datë 06.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Menaxhimit të Pronave në Njësinë Administrative Ostren”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 175, datë 02.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Menaxhimit të Pronave”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 176, datë 02.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Emergjencave Civile”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 50, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Trebisht”.

- ✓ Të anulojë aktin nr. 150, datë 11.04.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Gjoricë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 199, datë 21.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Zërqa*n”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 24/1, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Bujqësisë Mbrojtjes Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Shupenzë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 46, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Ostren, Trebisht, Martanesh dhe Zërqa*n”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 196, datë 19.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Shupenzë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 95, datë 07.09.2015, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist veterinarie*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 49, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Trebisht*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 44, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Ostren*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 37, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Gjoricë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 19, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 79, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Martanesh*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 21, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Zërqa*n”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 195, datë 19.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist e Barazisë Gjimore dhe Dhunës në Familje*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 48, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Trebisht*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 43, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Ostren*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 42, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Gjoricë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 16, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 81, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 27, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh*”.
- ✓ Të anulojë Kontratën e Punës, datë 01.09.2015, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialiste e arkivës, në Bulqizë*”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 158, datë 21.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Median*”.

- ✓ Të anulohet aktin nr. 17, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin *“Specialist i N.M për menaxhimin e pronave, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë”*.
- ✓ Të anulohet aktin nr. 184, datë 02.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin *“Specialist i Kontrollit në Terren”*, emëruar në detyrë me aktin.

2.Njësia përgjegjëse, të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, duke e ndarë në dy faza.

3.Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2017, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

4.Njësia përgjegjëse, të përmbyllë procesin e nisur për 18 procedurat e konkurrimit, dhe të fillojë procesin për 10 pozicionet e tjera të lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në Kreun IV *“Pranimi në shërbim civil”*, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*, të Departamentit të Administratës Publike.

Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimin dhe vlerësimit (*Komiteti i Përherëshëm i Pranimin për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- ✓ Të bëhen publike në faqen zyrtare, *“Shërbimi Kombëtar i Punësimit”*, në faqen zyrtare të Bashkisë Bulqizë dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:
  - a) Akti i shpalljes për plotësim, i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të

Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.

- b) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë *“lëvizja paralele”* ashtu edhe për fazën e dytë *“pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”*.
- c) Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë *“lëvizja paralele”* ashtu edhe për fazën e dytë *“pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”*.
- d) Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

**5.** Njësia përgjegjëse e Bashkisë Bulqizë, të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.

**6.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

**7.** Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.

**8.** Të njoftohet për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Bulqizë dhe Njësia Përgjegjëse e këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**